



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PEJË

Numri i lëndës: 2022:178052

Datë: 16.01.2023

Numri i dokumentit: 03860850

PKR.nr.174/22

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË PEJË-Departamenti për krime të rënda, me Kryetaren e trupit gjykues Violeta Husaj Rugova, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtores profesionale Besa Dervishaj, në çështjen penale ndaj të akuzuarit B.B.nga P., rruga “V. D.”, nr..., për veprë penale, “Mbajta në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve” nga neni 366 par.1 të KPRK-së, duke vendosur sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Pejë, Departamenti për krime të rënda PP/L.nr.228/22 të datës 13.09.2022, pas mbajtjes së shqyrtimit të dytë në prezencë të Prokurorit të shtetit Lumturije Vuçetaj, të akuzuarit B.B.dhe mbrojtësi i tij sipas autorizimit av. Ahmet Rexhaj me datë 23.12.2022 mori dhe shpalli, si dhe me datë 16.01.2023 përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

I akuzuari:

B. B., i biri i B. dhe i nënës S. e gjinisë A., i lindur me datë në P., ku edhe banon, rr. “V. D.”, nr... i martuar, babë i .. fëmijëve, ka të kryer shkollën e mesme, tregtar në tezge, i gjendjes së dobët ekonomike, i identifikuar në bazë të letërnjoftimit me numër, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, gjendet në liri.

ËSHTË FAJTOR

Për shkak se:

-Më parë dhe gjerë me datë 16.08.2022, në tregun e Ç. së Gj., K. P., i pandehuri në kundërshtim me nenin 4 par.1 nën par. 1.1 dhe 1.4 pika 1.1.11 dhe 1.4.4 sipas Ligjit për Armë (Ligji nr.05/L-022), ka mbajtur në pronësi dhe kontroll të paautorizuar dhe atë: një (1) elektroskok, dhe katër (4) sprej, në atë mënyrë që, ditën kritike pas zbatimit të urdhrit për kontroll-bastisje nga sektori i hetimeve, në hapësirën të cilën ishte duke e shfrytëzuar i pandehuri për shitje në tezgë e që gjendet në vendin e lartshënuar i janë gjetur dhe sekuestruar sendet të përshkruara si më lartë.

-Me çka ka kryer veprën penale “Mbajta në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve” nga neni 366 par.1 të ish KPRK-së.

Andaj, gjykata konform nenit 7,17 par.1,38,39, 46,47,48,49 nenit 69, 70, nenit 366 par.1 , të KPRK-së, si dhe nenit 365 të KPPRK-së, të akuzuarit i shqipton:

DËNIM ME KUSHT

Të akuzuarit B. B.

I përcaktohet dënim me burg në kohëzgjatje prej tre (3) muaj, i cili dënim nuk do të ekzekutohet në rast se i akuzuari brenda periudhës 1 (një) vjeçare nuk kryen ndonjë veprë të re penale.

Te akuzuarit i konfiskohet një (1) elektroskok dhe katër (4) sprej dhe të njëjtat pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi do të shkatërrohen të njëjtat gjinden në ruajtje sipas rastit policorë 2022-DI-81.

I akuzuari obligohet që në emër të në emër të paushallit gjyqësor gjykatës ti paguaj shumën prej 15 € dhe shumën prej 50 euro në emër të kompensimit për viktimat e krimit, në afat prej 15 ditësh pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Pejë, Departamenti për krime të rënda, ka ngrit aktakuzë PP/I.nr.228/22 të datës 13.09.2022, ndaj të akuzuarit B.B.nga P., rr. “V. D.”, nr..., për veprë penale, “Mbajta në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve” nga neni 366 par.1 të KPRK-së.

Pas leximit të aktakuzës në shqyrtimin fillestar nga ana e Prokurorit të shtetit PP/I.nr.228/22 të datës 13.09.2022, në seancën e shqyrtimit fillestar, gjykata është bindur se i akuzuari e ka kuptuar aktakuzën dhe të akuzuarit i ka dhënë mundësinë që të deklarohen për pranimin ose mos pranimin e fajësisë.

Në këtë rast gjykata ka udhëzuar të akuzuarin për rendësin dhe pasojat e pranimit të fajësisë dhe i akuzuari B.B.në shqyrtim fillestar ka deklaruar se nuk e pranon fajësinë.

Shqyrtimi i dytë në këtë çështje penale në kuptim të nenit 254 të KPPK-së, është mbajtur me datë 23.12.2022 prokurorja e shtetit ka deklaruar se pas vlerësimit të kundërshtimit të provave për hudhjen e aktakuzës në raport me shkresat e lëndës ka konstatuar pjesërisht qëndrojnë pretendimet e mbrojtësit dhe në këtë drejtim mbështetur në fletëparaqitjen për kundërvajtje të datës 13.09.2022 ndaj të pandehurit B.B.për shkak të veprës kundërvajtëse të përshkruar me nenin 19 pika 1 të Ligjit të prishjes së rendit qetësisë publike, ku është përshkruar, se ndaj të njëjtit kundërvajtja është paraqitur në raport me mjetet e përshkruara në dispozitiv, gjersa për një elektro shok, sprej, dhe .. boksa është iniciuar rast penal për të cilët është duke udhëhequr procedura pranë kësaj Gjykate sipas aktakuzës PP/I.nr.228/2022. Andaj në këtë drejtim bënë precizimin e dispozitivit të kësaj aktakuze duke heq nga i njëjti mjetet dhe atë në rreshtin e katërt ... mjete të mbrehtë-thikë, në rreshtin e pestë . shufra të metalta, .. boksa të metalit gjersa mbetet vetëm . elektro shok dhe . sprej .., meqenëse të njëjtat përveç bazës së potencuar si më lart nuk janë të kategorizuara në ligjin për armë. Ndërsa pjesa tjetër mbetet e pa ndryshuar, përveç dhe propozimit për konfiskim ku duhet të jetë konfiskimi i sendeve të cilat i kanë prezantuar në fillim të dispozitivit gjersa .. boksa të metalit për të njëjtat do të delegohen në procedurë kundërvajtëse sipas fletëparaqitjes 13.09.2022.

Mbrojtësi i të akuzuarit ka deklaruar se: meqenëse prokurorja e shtetit ka bërë riprecizimin e aktakuzës sa i përket përshkrimit faktik dhe propozimit për konfiskim atëherë kërkon që ti jepet mundësia të akuzuarit që të deklarohet për fajësinë.

I akuzuari B.B.ka deklaruar se: është konsultuar me mbrojtësin e tij dhe e pranon fajësinë për vepër penale që i vihet në barrë e pranon vullnetarisht pa kurrfarë presioni.

Prokurorja e shtetit ka deklaruar se: pajtohet me pranimin e fajësisë, pranimi i fajësisë është bërë vullnetarisht dhe në konsultim paraprak me mbrojtësin dhe ka mbështetje në shkresat e lëndës.

Mbrojtësi i të akuzuarit ka deklaruar se: pajtohet me pranimin e fajësisë, është i vullnetshëm dhe në përputhje me shkresat e lëndës dhe korrigjimin që e ka bërë prokurorja e shtetit.

Duke pasur parasysh të lartcekurat gjykata e ka aprovuar pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarit në shqyrtimin e dytë pasi që i akuzuari ka të drejtë të pranoj fajësinë në çdo fazë të procedurës dhe pasi që ka vërtetuar se nuk ekziston ndonjë rrethanë për hudhje të aktakuzës konform nenit 253 të KPPRK-së, se janë plotësuar kushtet nga neni 248 të KPPRK-së, atëherë në këtë çështje nuk është zbatuar procedura e provave, por gjykata ka vazhduar me shqiptimin e dënimit.

Gjykata pranuar pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarit bazuar në pranimin e fajësisë, si dhe duke pasur parasysh provat të cilat gjenden në shkresat e lëndës siç janë: raporti i shpejtë nga polici i rastit M. Ç. i datës 16.08.2022, raporti i policit hetues N. Z. #... i datës 16.08.2022, deklarata e të pandehurit B.B.e dhënë në vendin e ngjarjes me datë 16.08.2022 si dhe deklarata e dhënë në prokurori me datë 12.09.2022, vërtetimi për sekuestrimin e përkohshëm të sendeve i datës 16.08.2022 dhe fotografit e sendeve të sekuestruara, andaj gjykata erdhi në përfundim se në veprimet e të akuzuarit ekzistojnë të gjitha elementet e veprës penale të përshkruara si në dispozitiv të këtij aktgjykimi e për të cilin është shpallur fajtor.

Me rastin e vendosjes së vendimit mbi dënim gjykata i vlerësoj të gjitha rrethanat për dënimin konform nenit 69 dhe 70 të KPRK-së. Si rrethana lehtësuese gjykata vlerësoj se i akuzuari e ka pranuar fajësinë dhe gjendjen e dobët ekonomike. Nga rrethanat rënduese nuk gjeti asgjë. Në shkresa të lëndës prokuroria ka paraqitur evidencën për rastet policore të paraqitura për të akuzuarin, nga e cila rrjedh se i njëjti është i dyshuar për rastin-.-.... për vepër penale nga neni 328 i KPRK-së, dhe është shënuar vendimi fundit i gjykatës, dhe-.-.... na neni 305 të KPRK-së si i dyshuar, ndërkaq rastet e tjera nga evidenca janë kundërvajtje. Rastet e evidentuara policore gjykata nuk i ka vlerësuar si rrethana rënduese, pasi që gjykata në shkresa të lëndës nuk kishte dëshmi se si kanë përfunduar këto raste e në rastin e parë çfarë ishte vendimi i gjykatës.

Gjykata duke u gjendur para këtyre rrethanave lehtësuese dhe në mungesë të rrethanave rënduese, vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi duke konsideruar përcaktimi i dënimit dhe kushtëzimi në rast se kryen ndonjë veprë penale të re, është në përputhje me shkallën e përgjegjësisë penale të akuzuarit, dhe me intensitetin e rrezikimit të vlerave të mbrojtura të shoqërisë. Gjykata është bindur se vendimi mbi dënimin do të shërbej për arritjen e qëllimit të dënimit, siç është pengimi i të akuzuarit në kryerjen e veprës penale në të ardhmen si dhe në preventivën tjetër për personat tjerë që të përmbahen nga kryerja e veprave penale, gjithnjë duke u bazuar nenit 38 dhe 47 të KPRK-së.

Konform nenit 366 par. 3 të KPRK gjykata vendosi mbi konfiskimin si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Konform nenit 450 të KPPRK-së, gjykata mori vendimin mbi obligimin e të akuzuarit në paguarjen e paushallit gjyqësor si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Konform nenit 39 par.1,2,3 nën par. 3.1 të Ligjit për kompensim të viktimave të krimit, gjykata e obligoi të akuzuarin në pagesën e shumës si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Nga sa u tha më lart u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi konform nenit 365 të KPPRK-së.

**GJYKATA THEMELORE PEJË
DEPARTAMENTI I KRIMEVE TË RËNDA,**

2022:178052, 30.12.2022

Kryetarja e trupit gjykues

Violeta Husaj Rugova

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga koha e pranimt të të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, nëpërmjet kësaj Gjykate Themelore.